



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUIJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Krujë , me 11.06.2026

PROCESVERBAL – KONTRATE MALLI
ME OBJEKT

“BLERJE MATERIALE HIDRAULIKE PER BASHKINE KRUIJE”

**PËR ARGUMENTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR
KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot me date 11.06.2026 ne Kruje , nga ana e Njesise se Prokurimit ngritur me urdherin **nr.297 datë, 09.06.2026** me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me te dhenat si vijon:

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Materiale Hidraulike Per Bashkine Kruje”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 39715300-0 (Pajisje Hidraulike).

VLERA E FONDIT LIMIT: 1’249’850 (njëmiljon e dyqind e dyzet e nëntëmijë e teqind e pesëdhjetë) lekë pa t.v.sh

BURIMI FINANCIMIT :TE ARDHURAT E BASHKISE KRUIJE .

LLOJI I PROCEDURES :PROCEDURE E HAPUR E THJESHTUAR

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kruje ka hartuar procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**; (Ne vleren prej 2% te fondit limit te kontrates qe prokurohet)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a) Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2026 të leshuar nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë si dhe ushtron aktivitet sipas QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2026 për secilin operator).*

Shenim-Për të përmbushur këtë kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.9, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2026 të leshuar nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë si dhe ushtron aktivitet sipas QKB në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2026 për secilin operator).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe kërkesave specifike të Ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kritereve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

2.2-a) Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet e fundit ushtrimore/ financiare (2023,2024,2025), ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres e fondit limit te kontrates, qe prokurohet përkatësisht ne shumen prej **499'940(katerqind e nentedhjetë e nente mijë e nenteqind e dyzet) leke pa t.v.sh**

Shenim-Pika 2.2-a) plotesohet duke paraqitur edhe vertetimin perkates te Administrates Tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe **nenin 43**, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e marzhit te xhiros se kerkuar ne kufirin e percaktuar si me siper konsiderohet tregues i rendesishem per kapacitetin financiar te Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marre ne analize edhe faktin se vlera e fondit limit eshte e nen kufirin e ulet monetar dhe iu jep mundesine nder te tjera e dhe operatoreve ekonomik te vegjel dhe te mesem te kene akses ne oferte.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar si dhe VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", gjithashtu është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Pervoje e sukseshme ne levrimin e furnizimin e mallrave si me poshte:

Operatorët ekonomik për të provuar përvorjen e mëparshme të sukseshme duhet të paraqesin të dhënat provuese si më poshte në levrimin e furnizimin e mallrave si më poshte:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera/realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht jo më pak se vlera **249'970(dyqind e dyzet e nente mijë e nentëqind e shtatedhjetë) leke pa t.v.sh.**, dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi. kontraten pa vonesa dhe pengesa që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Vlera në kufirin e përcaktuar në VKM nr 285 datë 19.05.2021, është përcaktuese dhe objektive, si dhe garanton AK (Bashkinë Krujë), se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie si dhe të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1-a) Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër të furnizojë/transportojë mallrat objekt kontrate, në vendet e përcaktuara nga ana e Bashkisë Krujë me mjetet e tij që

ka ne dispozicion sipas kerkeses se AK. (Deklarate te leshuar nga Administratori i shoqerise).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku thuhet se ... **Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.** Disponueshmeria e furnizimit nga ana e OE është kerkese ekzigjente nga ana e AK, pasi mallrat objekt prokurimi, I sherbejn jo vetem institucionit te Bashkise Kruje por edhe objekteve arsimore te varesise se ketij institucioni e per pasoje permbushja ne kohe dhe disponibiliteti ne furnizim eshte domosdoshmeri per realizimin me sukses te kontrates.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Lista e artikujve te cilet do blihen jane si vijon te detajuara me specifikimet teknike perkatese

Nr	Emërtimi i materialeve	Njësia	Sasia	15 DITE	15 DITE
1	Tubë e zezë , pn 10 , Ø 20 mm	MI	300		
2	Saracineskë 1" (produkt CE)	Copë	5		
3	Saracineskë 2" (produkt CE)	Copë	5		
4	Saracineskë bronxi me filete Ø 90 me levë (produkt CE)	Copë	3		
5	Minisaraçineska (produkt CE)	Copë	50		
6	Tub plastmasi të brinjëzuar me muftë Ø 315	MI	480		
7	Pompë shtytëse 0.74 kw	Copë	2		
8	Pompë shtytëse + thithëse 0.73 kw	Copë	2		
9	Pompë shtytëse + thithëse 1.5 kw	Copë	2		
10	Galixhant Ø 40 - 50 mm	Copë	10		
11	Piletë me sustë për lavaman porcelani	Copë	20		
12	Mekanizëm kasete	Copë	30		
13	Rubinetë bronxi 1/2 "	Copë	50		
14	Tub flesibël 1/2 " , 30 - 50 cm (produkt CE)	Copë	50		
15	Tub flesibël 1/2 " , 3/8 30 - 50 cm per grupe (produkt CE)	Copë	150		
16	Zorre uji 3/4	MI	100		
17	Sifon lavamani	Copë	50		
18	Kaseta plastike komplet	Copë	30		
19	Grup lavapjate	Copë	10		
20	Saracineskë me volant Ø 100	Copë	1		
21	Fasheta plastike 20 - 60 cm	Pako	30		
22	Bashkuese PE Ø 90 mm , pn 16 (produkt CE)	Copë	10		
23	Brryla PE Ø 90 mm , pn 16 (produkt CE)	Copë	5		

24	Fasheta metalike riparimi tubë PE Ø 160 mm	Copë	2	
25	Tubë multistrat Ø 16	MI	100	
26	Grup lavamaui	Copë	50	
27	Grupe bideje	Copë	10	
28	Riparim elektromotor pompë shtytëse + thithëse 1.5 kw	Copë	2	
29	Riparim pompe shtytëse + thithëse 1.5 kw kuzhinete	Cope	1	
30	Katuç grup lavani , lavapjate , dushi , bide	Cope	30	
31	Kaseta kolektori metalike	Cope	2	
32	Saraçineska 3/4 me hollandez për tubë multistrat	Copë	5	
33	Buketon Ø 16 për kolektor me presim	Cope	30	
34	Tapa bronxi femër / mashkull	Copë	30	
35	Xhunto 3/4 x 20 me presim	Copë	10	
36	Pilete HL	Copë	2	
37	Pilete lineare	Copë	1	
38	Shirit metalik për fiksion	MI	30	
39	Tubë pvc Ø 50 , 1ml / 2 gota	Copë	15	
40	Bryla pvc Ø 50 , 45 - 90 ⁰	Copë	30	
41	Reduksion pvc Ø 50 - 40	Copë	10	
42	Tapa pvc Ø 50	Copë	10	
43	Brragë	Copë	25	
44	Tubë pvc Ø 110 , 1ml / 2 gota	Copë	15	
45	Bryla pvc Ø 110 , 45 - 90 ⁰	Copë	10	
46	Reduksion pvc Ø 110 - 50	Copë	5	
47	Tapa pvc Ø 110	Copë	5	
48	Brragë Ø 110 x 50	Copë	5	
49	Teflon	Copë	30	
50	Zevendesim pakete elektronike pompë zhytëse shkolla Mazhe	Copë	1	
51	Sprucator montuar në tubë të zezë	Cope	500	
52	Fuçi plastike 200 litra	Cope	4	
53	Bolier 80 litra	Cope	2	
54	Tubë pvc Ø 110 , ngjyrë gri	ML	30	

Shenim: Mbyllet me nr.rendor 54.

- Hartimi i specifikimeve teknike për blerjen e *artikujve objekti prokurimi* sipas listes se miratuar ne preventivin perkates është bërë duke iu referuar shkresës së Drejtorise se Sherbimeve dhe Investimeve Publike **nr.4361Prot, date 02.06.2026**, duke identifikuar per cdo pajisje specifikimin dhe karakteristikat perkatese teknike.te cilat plotesojne nevojat respective te Bashkise Kruje ne mirembajtjen *e infrastruktures publike te natyres hidraulike dhe permiresimit progresiv te kesaj infrastrukture.*, dhe me konkretisht ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te normave perkatese te Ligjit Nr.10 489, datë 15.12.2011 ‘‘Për tregtimin dhe

mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” , kerkesat e ligjit te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".

- ***Specifikimet teknike të përcaktuara për materialet hidraulike objekt prokurimi janë hartuar në funksion të natyrës së përdorimit të tyre në instalime dhe pajisje industriale, ku kërkohet nivel i lartë sigurie, besueshmërie dhe qëndrueshmërie në punë. Këto materiale do të përdoren në kushte operative që kërkojnë pajisje të certifikuara, me parametra të qartë teknike dhe me performancë të garantuar.***
- Specifikimet teknike përcaktojnë karakteristikat e mallit që prokurohet, duke e përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë sipas objektit të prokurimit, të cilat krijojnë kushte për konkurim të paanshëm dhe të hapur për të gjithë operatorët ekonomik, duke mundësuar një trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët e interesuar. Këto specifikime teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që krijojnë mundësinë e konkurrencës dhe trajtim të barabartë nga marka të ndryshme të prodhimit të automjeteve për të gjithë Operatorët Ekonomikë e interesuar.
- Sa i perket standartit te tyre per cdo artikull ato jane hartuar duke marre ne konsiderate percaktimet respektive sipas artikujve dhe standartit te pranuar te tregut si dhe kerkesat perkatese te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".
- Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive. Në respektim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjitha rastet kur përmendet “markë”, ”standart respektiv i referuar “ do te pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.
- Argumentim: Specifikimet teknike u hartuan nga specialistet e fushës, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.
- **Fondi limit** per proceduren me objekt “**Blerje materiale hidraulike per Bashkine Kruje**”, eshte hartuar duke iu referuar cmimeve te tregut per kategorin e mallrave/artikujve te ngjashem ,sipas referimeve dhe metodave te parashikuara ne nenin 76.c te Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 , “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK

Genc Halili

Melisa Kupa

Mikeda Caca